



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
SHËRBIMI PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT

RAPORTI VJETOR I PUNËS

2016

Në kuadër të detyrimeve të parashikuara në ligjin nr. 70/2014 për “Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”, për përmbushjen e misionit dhe objektit të veprimtarisë së Shërbimit si dhe në zbatim të objektivave e masave të përcaktuar në Programin Vjetor të Punës të miratuar nga Ministri i Punëve të Brendshme dhe Plani Vjetor i Punës së Shërbimit, i miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i SH.Ç.B.A-së nr. 49, datë 10.02.2016, gjatë vitit 2016 nga strukturat e Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, janë arritur këta tregues kryesore:

❖ **Përfundimi i fazës implementuese të ligjit nr. 70/2014 për “Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme,** nëpërmjet hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore, në funksion të zbatimit të këtij ligji:

- *Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm nr. 175, datë 29.06.2016 për “Miratimin e Manualit të Protokolleve të Punës për çdo funksion organik, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”.*
- *Urdhri i Përbashkët i Drejtorit të Përgjithshëm të SH.Ç.B.A-së me Drejtorin e Policisë së Shtetit nr. 1360, datë 09.09.2016 për “Miratimin e manualit mbi procedurat dhe metodat e kryerjes së testit të integritetit”.*
- *Urdhri i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 494, datë 07.09.2016 për “Miratimin e ndryshimeve në Strukturën dhe Përbërjen Organike të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”.*

Miratimi dhe zbatimi i normave dhe rregullave të parashikuara në këto akte nënligjore kanë standardizuar procedurat e duhura në përmbushjen e aspekteve të veçanta të veprimtarisë së Shërbimit, si;

- në fushën e profesionalizmit, përgjegjëshmërisë dhe llogaridhënies së personelit të SH.Ç.B.A-së;
- në fushën e rritjes së veprimtarisë parandaluese të strukturave të Shërbimit, me qëllim nxitjen e integritetit profesional e etikë të punonjësve të strukturave, objekt i veprimtarisë së Shërbimit;
- në fushën e detyrimeve ligjore të parashikuara në lidhje me implementimin e tij nga ana e organizimit strukturor dhe funksional të Shërbimit.

❖ **Veprimtaria parandaluese**, e arrituar nëpërmjet:

- Aktivitetit informuese e sensibilizues
- Ankesa e denoncime
- Inspektime e rekomandime

– **Aktiviteti informues e sensibilizues**

Marrëdhëniet me publikun janë një hallkë e rëndësishme e çdo organizate dhe efikasiteti i ndërtimit të kësaj marrëdhënie lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me performancën e agjencive dhe suksesin e tyre në komunikimin me publikun. Në vitet e fundit marrëdhëniet me publikun janë parë si një urë shumë efikase bashkëpunimi për rritjen e efektivitetit në arritjen e qëllimeve të përbashkëta e në mënyrë të veçantë në luftën kundër korrupsionit, duke i krijuar qytetarëve përmes hapësirave dhe kanaleve të komunikimit mundësinë për të qënë faktor kyç në këtë luftë të përbashkët.

Gjatë vitit 2016, nga Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, u realizua një **“Aktivitet promovues, informues e sensibilizues”**, me qëllim prezantimin e Shërbimit tek publiku, njohjen e tij, misionin, objektin e veprimtarisë, organizimi dhe funksionimi, kompetencat dhe përgjegjësitë e deri tek infrastruktura e ngritur dhe vënë në shërbim të publikut për të komunikuar me ne, për të denoncuar çdo sjellje joetike apo shkelje ligjore të kryer nga punonjësit e strukturave, dhe për të forcuar këtë bashkëpunim e veprim ndërmjet nesh, në funksion të pritshmërive të publikut përsa i përket rendit dhe sigurisë publike.

- Aktiviteti i organizua në qarqet - Shkodër, Lezhë, Korçë, Durrës, Vlorë
- U zhvilluan takime me **1500 nxënës dhe studentë** të:
 - Universiteti “Luigj Gurakuqi”, në Shkodër
 - Shkolla e mesme “Hydajet Lezha”, në Lezhë
 - Universiteti “Fan Noli”, në Korçë
 - Universiteti “Aleksandër Moisiu”, në Durrës
 - Universiteti “Ismail Qemali”, në Vlorë
- Takime me qytetarë në PKKK, Zyrat e Shërbimit për Publikun
- Takime me përfaqësues të pushtetit vendor
- Takime me punonjës e drejtues të Strukturave
- U shpërndanë
 - **1500** “Udhërrëfyes për Publikun” – informacion mbi Shërbimin
 - **2000** fletëpalosje – informacion mbi portat e komunikimit
 - **2000** kartvizita – informacion mbi linjën e gjelbër

– Ankesa e denoncime

Dimensioni i ri në marrëdhënien me komunitetin, nëpërmjet ndryshimit të sjelljes, të vepruarit dhe të qasjes së Shërbimit ndaj zgjidhjes së problematikave të qytetarëve dhe shërbimit të ofruar, reflektohet në treguesit sasiorë e cilësorë të veprimtarisë së hetimit administrative të ankesave përgjatë vitit 2016. Konkretisht strukturat e SH.Ç.B.A-së, kanë marrë dhe trajtuar:


– Telefonata të publikut në **Linjën e Gjelbër 0800 90 90 – 4082** telefonata

– Ankesa të marra në nivel qendror dhe vendor – **866** ankesa

Nga analizimi i gjithë produktit të përfutur gjatë hetimit administrativ të ankesave trendi i shkeljeve administrative, *mbizotërohet nga “për vendosje gjobë në mënyrë të padrejtë”, “shpërdorim me detyrën”, “mosveprim të strukturave të policisë” dhe “shkelje të procedurave standarde të punës”.*




Ndërsa sipas strukturës, numri më i madh i ankesave është për strukturat e DVP Tiranë, pasuar nga DVP Durrës, DVP Shkodër, DVP Vlorë, DVP Lezhë e DVP Fier. (grafiku nr. 2)



Nga trajtimi i ankesave në tërësi gjatë periudhës analizuese ka rezultuar se;

- në **60** raste nga **80** punonjës policie janë kryer shkelje të karakterit **administrativ**, duke sugjeruar fillimin e ecurisë disiplinore nga Drejtoria e Standarteve Profesionale në Policinë e Shtetit, për punonjësën objekt ankimi;
- në **8** raste nga **10** punonjës policie janë kryer shkelje të karakterit **penal**, duke kryer referimin pranë organit të Prokurorisë, për punonjësën objekt ankimi.
- në të gjitha rastet e tjera veprimet e punonjësve kanë qenë konform rregullave dhe Procedurave Standarde të Punës.



Problematika dhe rekomandime:

Nisur nga trendi i shkeljeve të evidentuara nga ankesat e qytetarëve të ardhura për vitin 2016, ankesat me objekt “vendosje e padrejtë gjobë” zënë rreth 22% të totalit të ankesave dhe për 15 punonjës të strukturave të qarkullimit, objekt ankimi, është sugjeruar fillimi i ecurisë disiplinore. Gjatë hetimit administrative të këtyre rasteve dhe analizimit të situatës në përgjithësi janë evidentuar problematika që pengojnë në mirëfunksionimin e strukturave të policisë rrugore dhe shërbimeve të patrullave të përgjithshme, të cilat kanë si detyrë funksionale kontrollin e respektimit të rregullave të qarkullimit rrugor dhe vendosjen e masave administrative në rastin e konstatimit të shkeljeve. Për përmirësimin e situatës, rekomandohet të merren masa në:

- Respektimit dhe zbatimin e detyrimeve të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore që përcaktojnë procedurat dhe personat përgjegjës në “evidentimin, marrjen dhe njoftimit e shtetasve për shkeljen e kryer”.
- Rritjes së bashkëpunimit me strukturat përkatëse për pajisjen me sinjalistikë (Ministria e Transporteve, Bashki).
- Trajnimit të vazhdueshëm të punonjësve të policisë, për kuadrin ligjor dhe nënligjor dhe për normat e etikës në komunikim.

– Inspektim dhe rekomandime

Gjatë vitit 2016 nga Sektori i Inspektimit të Përgjithshëm, në Drejtorinë e Inspektimit & Ankesave të SH.Ç.B.A-së, në funksion të vlerësimit dhe kontrollit të strukturave, objekt i veprimtarisë së Shërbimit, me qëllim përcaktimin nëse veprimtaria e strukturave ka qenë në nivelin e duhur dhe në përputhje me interesat e publikut dhe ligjshmërinë; me synimin që strukturat e inspektuara të ballafaqohen me konstatimet dhe rekomandimet e dhëna për të qenë më efçente dhe efektive në përmbushjen e objektivave dhe arritjes së qëllimit të përbashkët, rritjen e besimit të publikut nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së shërbimeve dhe performancës së organeve publike, në zbatim të Planit Vjetor të Inspektimeve dhe problematikave të dala gjatë vitit, janë arritur këto rezultate pune:

Janë kryer gjithsej 64 inspektime, konkretisht:

- 12 Inspektime të planifikuara
- 5 Inspektime të paplanifikuara
- 1 Inspektim në bashkëpunim me Inspektimin e Përgjithshëm të Ministrit
- 1 Inspektim në bashkëpunim me Drejtorinë e Kërkimit dhe Hetimit
- 2 Inspektime në bashkëpunim me Inspektoriatin Policor të Kosovës
- 43 Inspektime për trajtim ankesash

Konkluzione;

Janë evidentuar në Raportet e Inspektimit, për strukturat objekt inspektimi **167 gjetje.**

Rekomandime;

Janë dhënë në Raportet e Inspektimit, për strukturat objekt inspektimi **115 Rekomandime.**

Në përfundim të hetimit administrativ të inspektimeve, është konstatuar se:

- Në **3 raste për 4 punonjës** të strukturave janë referuar materialet për fillimin e procedimit penal në prokuroritë e rretheve Gjyqësore Elbasan dhe Sarandë.
- Për **188 punonjës të strukturave** është sugjeruar fillimi i ecurisë disiplinore, si personat përgjegjës për shkeljet e evidentuara.


❖ **Veprimtaria zbuluese, e dokumentimit ligjor dhe goditjes së veprimtarisë së kundraligjshme të kryer nga punonjës të Strukturave.**

Në funksion të hetimit penal, nga strukturat vendore dhe qendrore të Shërbimit, për vitin 2016 janë dërguar pranë organit të Prokurorisë materialet kallëzuese ndaj punonjësve të policisë që dyshohet se kanë kryer elementë të veprës penale, konkretisht:

- **160** kallëzime penale për
- **180 persona**, nga të cilët
- **42** punonjës policie i nivelit të parë drejtues,
- **127** punonjës policie të nivelit zbatues,
- **1** punonjës policie civil,
- **6** punonjës të Gardës së Republikës
- **4** punonjës i PMNZSH dhe
- **17** shtetas.

Arrestuar në flagrancë/ndaluar **57 persona**, nga të cilët **6** punonjës policie të nivelit të parë drejtues, **36** punonjës policie niveli zbatues, **2** efektiv të Gardës, **2** efektiv të PMNZSH-së dhe **11** shtetas.

Nga analiza e informacioneve të grumbulluara dhe materialeve referuese në prokurori, edhe për vitin 2016 trendi i veprave penale vazhdon të jetë i njëjtë, e konkretisht:



Ndërsa forma të shfaqjes së korrupsionit në polici, janë evidentuar si:

- Shpërdorimi i detyres me tendencën për marrje ryshfeti.
- Favorizimi apo implikimi në veprimtari të kundraligjshme si: kultivimi i bimëve narkotike; trafiku i drogës, kontrabandës, etj, me synim marrjen e një ryshefti.
- Pasivitet negativ në përmbushjen e detyrës me synim marrjen e një përfitimi moral dhe material.

xxx

Rezultatet e punës së SH.Ç.B.A-së në parandalimin, zbulimin, dokumentimin ligjor dhe goditjen e rasteve të kultivimit të bimëve narkotike dhe trafikut të drogës

Veprimtaria e strukturave të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në kuadër të parandalimit, zbulimit dhe goditjes së kultivimit të bimëve narkotike dhe implikimit në këtë veprimtari të punonjësve të policisë, është bazuar jo vetëm në ligjin nr.70/2014 por edhe të planit konkret të masave të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i SH.Ç.B.A.-së, “Për monitorimin, kontrollin dhe goditjen e veprimtarisë së kundërligjshme të punonjësve të strukturave, gjatë fushatës parandaluese për kultivimin e bimëve narkotike”, duke arritur këto rezultate konkrete:


- **Grumbullimi dhe shkëmbimi i informacionit**
 - o **126** informacione të verifikuara me forma të punës dhe mjete teknike speciale operacionale.
- **Rezultate konkrete**
 - o zbulimin dhe asgjësimin e **490.370 bimëve narkotike**,
 - o kryerjen e 7 operacioneve të përbashkëta **Elbasan, Shkoder, Dibër, Vlore, Berat, Korçë e Durrës**
 - o **8 punonjës policie dhe 5 shtetas të arrestuar**

Identifikuar, ndjekur, hetuar dhe proceduar:

- o **42** kallëzime penale për
- o **53** punonjës të strukturave, sipas nivele dhe gradave të ndryshme.

Binomi zbulueshmëri – ndëshkueshmëri, për masat administrative, ka qenë i frytshëm edhe përgjatë vitit 2016, pasi bashkëpunimi me Drejtorinë e Standardeve Profesionale ka qenë mjaft rezultativ. Mbi bazën e materialeve të dërguara nga strukturat e Shërbimit apo vetë kërkesave të Drejtorisë së Standardeve Profesionale mbi ecurinë e hetimeve administrative apo penale të inicuar për punonjës policie, janë inicuar dhe dhënë gjithsej **160 masa disiplinore**.

Gjithashtu si rezultat i bashkëpunimit të ngushtë SH.Ç.B.A- Prokurori, i reflektuar në numrin e procedimeve penale të sukseshme, si pasojë e realizimit në kohë e me cilësi të detyrave të deleguara nga organi i akuzës strukturave vendore dhe qendrore të Shërbimit, janë siguruar provat e mjaftueshme që vërtetojnë dhe dokumentojnë veprimtarinë e kundraligjshme të kryer nga punonjës të strukturave dhe dërgimin e çështjeve në gjykim për **38 punonjës**, konkretisht:



❖ Modernizimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit nga strukturat e Shërbimit.

Evoluimi i teknologjisë që po karakterizon epokën në të cilën jetojmë, i ka dhënë ngjyrimin kryesor jo vetëm zhvillimit të shoqërisë por edhe fushave të tjera siç është edhe siguria dhe agjencitë ligjzbatuese në mbarë botën. Teknologjia e informacionit dhe komunikimit, e cila po zhvillohet çdo ditë me hapa galopantë, është pjesë integrale dhe e pandashme e veprimtarisë së shërbimeve inteligjente e agjencive ligjzbatuese në vendet e Bashkimit European e jo vetëm, duke standarduar dhe modernizuar procedurat e punës, rritur cilësinë dhe efikasitetin e rezultateve të tyre.

Prandaj, vitit 2016, shënon dhe një pikë kthese për modernizimin e teknologjisë së përdorur gjatë veprimtarisë së strukturave të Shërbimit, **falë kjo edhe mbështetjes së dhënë nga Z. Ministër**, duke hedhur hapat e para të krijimit të një infrastrukture të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.



Gjatë këtij viti, janë kryer procedurat e prokurimit të klasifikuar për projektin **“Ngritja e Intranetit dhe Shërbimeve të Dedikuara për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”**, lidhur kontrata me operatorin ekonomik fitues dhe përfunduar faza e parë e projektit me një fond 10 milion lekë (të reja), nga buxheti i shtetit. Faza e dytë dhe i gjithë projekti do të përmbyllet gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2017.

Ky projekt do të rrisë kapacitet e brendshme, modernizojë infrastrukturën logjistike me teknologjitë e pajisjet bashkëkohore në përdorim nga shërbimet homologe të vendeve më të përparuara të EPAC-ut dhe Bashkimit European.

❖ Menaxhimi i burimeve njerëzore, edukimi, trajnimi, logjistika e financa

– Edukimi, trajnimi i personelit

Gjatë vitit 2016, kanë marrë pjesë **50 punonjës** të Shërbimit në;

- **8 trajnime**
- **2 takime/vizita pune**

- Trajnimi i brendshëm për **32 punonjës** të rinj të Shërbimit, mbi bazën e “programit të Trajnimit të Brendshëm”, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit.
- **1 punonjës** i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, pjesë e trajnimit të organizuar nga ASPA, “Trajnimi i detyrueshëm për nëpunësin civil – 2 javor”.
- **2 punonjës** të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, pjesë e trajnimit të organizuar nga DAP me tematika “Planifikimi strategjik dhe metodat inovative në menaxhimin e burimeve njerëzore”.
- **7 punonjësve** të Shërbimit, pjesë të trajnimit të organizuar nga DSIK, me tematikë “Trajtimi i informacionit sekret industrial dhe aktet ligjore dhe nënligjore që normojnë atë”.
- **2 punonjësve** të Shërbimit, pjesë të trajnimit organizuar nga Akademia e Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar me tematikë “Mbi zhvillimin e integritetit”.
- **1 punonjës** i Shërbimit, pjesë e trajnimit me temë “trajnimi për aftësitë e avancuara në fushën e zbulimit të dokumentave të fallsifikuara”, Asmterdam, Hollandë.
- **2 punonjës të Shërbimit**, pjesë e trajnimit me temë “Për prodhimin dhe administrimin e informacionit “Sekret të Nato-s”, organizuar nga DSIK në datat 13 – 14 Dhjetor.
- **1 punonjës** i Shërbimit, pjesë e tryezës së rrumbullakët me tematikë “Përgjegjëshmëria, Kontrolli dhe Mbikqyrja e Sektorit Privat të Sigurisë”, Beograd, Serbi në datat 8 – 9 Dhjetor 2016.
- **2 punonjës** të Shërbimit, pjesëmarrës në Konferencën Vjetore të Punës së EPAC, me tematikë “Roli i sektorit privat në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit”, në datat 15 – 17 Nëntor 2016, Riga, Letoni.

– Rekrutimet, emërimet, transferimet, lirimet nga detyra

- **3 procedura konkurrimi** për pranimin në SH.Ç.B.A
 - **16 konkurrentë**,
 - **12 fitues**
 - **10 emëruar në detyrë**,

- **23** transferime brenda strukturave për nevoja të punës së Shërbimit
- **12** punonjës larguar nga SH.Ç.B.A-ja
 - **2** punonjës në reformë për shkak të implementimit të ligjit
 - **4** punonjës me motivacionin “me kërkesën e tyre“
 - **6** punonjës me motivacionin “me kërkesë për punësimin në struktura të tjera”.
- **Spektori i financës, viti 2016:**
 - shpenzimet buxhetore të miratuara **175,474,000** lekë
 - shpenzime të realizuara **172,441,984** lekë ose në masën **98%**.

Pasqyra përmbledhëse e realizimit të fondeve buxhetore të miratuara; (në lekë)

Nr.	Art.	Emërtimi	Plani	Realizimi	Diferenca	Real. në %
1	600	Paga & shpenz. personeli	115,789,000	114,574,886	1,214,114	99%
2	601	Sigurime shoqërore	19,055,000	18,735,485	319,515	98%
3	602	Mallra e shërbime	23,200,000	22,801,615	398,385	98%
4	606	Transf.buxhetet familjare	2,630,000	2,516,073	113,927	96%
5	231	Investime	14,800,000	13,813,925	986,075	93%
TOTALI			175,474,000	172,441,984	3,032,016	98%

Sigurimi i Personelit (Vettingu)

Gjatë vitit 2016, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në cilësinë e një prej Autoriteteve Verifikuese, ka trajtuar kërkesat e ardhura nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret Shtetëror” (DSIK), Policia e Shtetit, AISM dhe SHISH. Pas procedurave verifikuese ndërmjet tre autoriteve verifikuese dhe strukturave të policisë kriminale, në Policinë e Shtetit, Shërbimi ka përmbyllur 5971 praktika verifikuese për sigurimin e personelit dhe pajisjen me “çertifikatë sigurie”. Të gjitha verifikimet janë trajtuar brenda afateve të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore që normojnë këtë veprimtari. Në raport me vitin e kaluar janë trajtuar rreth 30 % më shumë procedura verifikuese.

❖ OBJEKTIVAT PËR VITIN 2017

Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, si pjesë e rrjetit të institucioneve ligjzbatuese në vendin tonë, duke u nisur nga analizimi i problematikave dhe fenomeneve të evidentuara përgjatë vitit 2016 në veprimtarinë dhe performancën e strukturave, objekt i punës së Shërbimit, si dhe duke u fokusuar në prioritetet dhe objektivat strategjike të Qeverisë Shqiptare dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, që përkojnë me proceset reformuese për integrimin e Shqipërisë së Bashkimit Europian, do të përqëndrojë punën gjatë vitit 2017 në këto aspekte kryesore:

➤ **Veprimtaria parandaluese, që do të realizohet nëpërmjet;**

- Kryerjes së “testeve të integritetit”, në sektorët e evidentuar si më me risk të lartë korrupsioni dhe jo vetëm, në funksion të forcimit të integritit policor dhe ruatjes së pastërtisë së figurës së personelit të Strukturave.
- Sensibilizimit, njohjes së Shërbimit dhe strukturave të saj të posaçme civile për marrjen dhe trajtimin e ankesave e denoncimeve të qytetarë, kjo duke marrë pjesëmarrje në emisione televizive, që trajtojnë probleme që lidhen me rendin dhe sigurinë publike, pritshmëritë e publikut nga shërbimi i ofruar nga strukturat e Policisë së Shtetit.
- Kryerjes së Inspektimeve me objekt konkret, duke dalë nga inspektimet rutinore apo panoramike, të fokusuar në problematika dhe fenomene evidente, me synim dokumentimin ligjor të shkeljeve të konstatuara.

➤ **Veprimtaria zbuluese dhe goditëse, që do të realizohet nëpërmjet:**

- Rritjes së forcës zbuluese në sasi e cilësisë, si rezultat i forcimit të kapaciteteve të veprimtarisë inteligjente, zbatimit dhe aplikimit të gjerë të metodave dhe teknikave speciale të kësaj veprimtarie.
- Hetimeve proaktive për zbulimin, dokumentimin ligjor dhe goditjen e rasteve të veprimtarisë korruptive, trafikeve, krimet të organizuar ku implikohen punonjës të strukturave, në bashkëpunim të ngushtë me Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore dhe atë për Krimet e Rënda.

- **Forcimi i kapaciteteve të brendshme të Shërbimit, që do të realizohet nëpërmjet;**
 - Përfundimit të projektit “Për ngritjen e Intranetit dhe Shërbimeve të Dedikuara për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe të Ankesat”, duke modernizuar dhe future në përdorim mjete dhe teknika bashkëkohore të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.
 - Edukimit, ngritjes profesionale dhe ecurisë në karrierë të personelit të Shërbimit, mbi bazën e trajnimeve të brendshme, trajnimeve të posaçme dhe trajnimeve për ecurinë në gradë të personelit, në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë, Policia e Shtetit.

- **Bashkëpunimi ndërinstytucional, që do të realizohet nëpërmjet:**
 - Bashkëpunimit me strukturat, në veçanti ato audituese dhe vetkontrolluese brenda Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës e PMNZSH-së mbi bazën e protokolleve të bashkëveprimit.